



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:246090
Datë: 07.03.2025
Numri i dokumentit: 06955397

C.nr.3562/23

GJYKATA THEMELORE NË PEJË—Departamenti Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtar Vegim Maloku në çështjen juridike kontestimore të paditësit V. V. nga Peja, të cilët i përfaqëson Sokol Mushkolaj avokat nga Peja, kundër të paditurës S i P në Pejë,, me adresë rr. “N.T.”, p.n, Pejë, baza juridike: *Kompensim i pagës 13-të*, vlera e kontestit: 5.040,00 euro, jashtë seancës, me datë 07.03.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.REFUZOHET në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit me të cilën kanë kërkuar që të DETYROHET e paditura S i P në Pejë, që paditësit V. V. në emër të pagës së 13- të për tre vitet e fundit nga mardhënia e punës të ia paguan shumën prej 3,780 euro si dhe shumën prej 1,260 euro në emër të pagës jubilarë apo gjithsej shumën prej 5,040 euro e me kamatë ligjore, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e nën kërcënim përmbarimi.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarës së tyre, kanë paraqitur padi kundër të paditurës, me objekt kontesti: *Kompensim i pagës 13-të dhe pagës jubilarë*, vlera e kontestit: 5.040,00, duke përshkruar gjendjen faktike si në vijim: Paditëset përmes përfaqësueses së autorizuar, kanë paraqitur padi për kompensimin e pagës 13-të, e në mbështetje të dispozitave ligjore të nenit 17 par.2 të Kontratës Kolektive Sektoriale të lidhur në mes të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Federatës së Sindikatave të Kosovës me numër të protokollit 05-3815, të datës 12.06.2018, lidhur

me nenin 55 par.1, të Ligjit, nr.03/L 212. Paditësit e lartcekur kanë themeluar marrëdhënie pune tek e paditura, ku vazhdojnë edhe më tutje. Të njëjtit edhe pse i kanë plotësuar kushtet për kompensimin deri më tani nuk i janë paguar asnjëherë pagat e trembëdhjeta ashtu siç ju takojnë sipas Kontratës Kolektive Sektoriale. Me datë 20.11.2023, përmes të autorizuarit të tyre paditësit kanë parashtruar kërkesë për pagesën e pagës së 13-të, tek e paditura, mirëpo e njëjta e ka refuzuar kërkesën e paditësve me arsyetim se institucioni gjatë viteve 2018-2022 nuk ka pasur dhe as nuk ka mjete buxhetore për të kryer këtë kompensim, andaj paditësit janë të obliguar që kërkesën e tyre të realizojnë përmes rrugëve gjyqësore, andaj i propozojmë gjykatës që pas administrimit të provave kërkesëpadinë e paditësve të aprovojë në tërësi si të bazuar.

E paditura, përmes përgjigje në padi ka theksuar se: E kontestojmë në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë lidhur me pagat e 13-ta, ngase me nenin 17 par.2 të Kontratës Kolektive Sektoriale (Shëndetësisë), punëmarrësit ka mundur të i kompensohet paga e 13-të, për çdo vitë kalendarik në vlerë të pagës bazë sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit, mirëpo në këtë rast punëdhënësi nuk ka pasur mundësi buxhetore që paditësve të ju bëjë kompensimin e pagës 13-të, e që rrjedhimisht që kjo kërkesë tashmë është parashkruar. Andaj, nga të lartcekurat i propozojë gjykatës që pas shqyrtimit të lëndës dhe të administrimit të provave të marr aktgjykimi refuzues. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitën e nenit 8 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridike civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

-Kërkesëpadia e paditësve është në tërësi e PABAZUAR.

Gjykata lidhur me çështje ka vendosur jashtë seancën gjyqësore dhe atë referuar vendimit të GJEDNJ-së *Saccoccia kundër Austrisë* (Aktgjykim i 18 dhjetorit 2008), pasi pretendimet e palëve kanë qenë qarta dhe të njëjtat ngërthenin çështje ekskluzivisht ligjore të cilat nuk e kanë bërë të domosdoshme mbajtjen e seancës publike, në ndërlidhje edhe me natyrën jo komplekse e çështjes, e ndërlidhje me nenin 399 par.1 të LPK-së që përcakton se “*Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia*”.

Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se palët paditëse ishin të punësuar tek e paditura dhe se gëzonin shpërblimin në emër të pagës bazë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, mirëpo kontestues ishte baza e kërkesëpadisë, pra nëse palës paditëse i takon apo jo e drejta lidhur me kompensim të pagave të 13-ta të papaguara.

Në bazë të kontratës së punës, me numër protokollit 21/7, të datës 18.05.2020, të lëshuar nga S i P në Pejë,, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësit V. V., ka të themeluar marrëdhënien e punës tek e paditura që nga data 18.03.2020, dhe gëzon shpërblimin në pagën bazë prej 659.00 euro, fakt i cili nuk ishte kontestues në mes të ndërgjyqësve.

Gjykata lidhur me bazën e kërkesëpadisë, ka vendosur duke u bazuar në nenin 17.2 të Kontratës Kolektive Sektoriale e datës 12.06.2018 e lidhur në mes të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, ku përcaktohet se *“Punëmarrësi mund të kompensohet me pagën e 13 – të për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit”*.

Në interpretim të kësaj dispozite ligjore, çështja e kompensimit të pagës së 13-të, për punëtorët shëndetësor është e kushtëzuar me mundësitë financiare të punëdhënësit, përkatësisht nëse ka mjete buxhetore. Nga kjo rezulton se dispozita e sipër theksuar duhet interpretuar në atë mënyrë që e drejta për realizimin e pagës së 13-të, lind kur punëdhënësi nuk e përmbush atë, ndërsa në asnjë mënyrë nuk arrin të provoj se nuk ka pasur mundësi buxhetore. Sipas kësaj gjykate, nëse punëtori paraqet kërkesë për kompensimin e shpërblimit të pagës së 13-të, duke pretenduar se ka plotësuar kushtet e përcaktuara, mbetet në barrën e punëdhënësit që në secilën fazë të procedurës kur gjykata i jep mundësi për tu deklaruar me prova konkrete, të provoj çështjen e mundësisë buxhetore, për shpërblimin e tillë. *(Mendim Juridik i miratuar në Seancën e Përgjithshme të Gjykatës Supreme, të datës 09 tetor 2023).*

E paditura, përmes përgjigjes në padi, kishte dorëzuar si provë materiale, njoftimin e datës 21.12.2023 me numër protokollit 3823 lëshuar nga drejtori Financiar / ekspert i ekonomik dhe menaxhmentit shëndetësorë në kuadër të SHSKUK. Përmes këtij njoftimi, gjykata ka vërtetuar faktin vendimtar në këtë çështje, e që është se pala e paditur, në periudhat në të cilat pala paditëse, kishte kërkesa për pagat e 13 – ta të pa paguara, në fakt ka qenë në deficit buxhetor.

Tutje, përmes këtij njoftimi vërtetohet se në kategorinë e pagave dhe mëditjeve, e paditura, në vitin 2018, si buxhet fillestar për këtë kategori kishte shumën prej 55,938,388.67 euro, e nga të cilat ishin shpenzuar 58,242,229.27 euro, e që diferenca në këtë vit paraqitet të jetë -2,3030,840.60 euro.

E njëjta gjendje, paraqitet edhe në vitet pasuese, konkretisht në vitin 2019, ku në kategorinë e pagave dhe mëditjeve për këtë vit, buxheti fillestar ka qenë në shumë prej 57,945,237.00 euro, kurse buxhet i shpenzuar në shumë prej 62,737,000.00 euro, kurse diferenca në shumë prej -4,788,763.00 euro.

Në vitin 2020, buxheti fillestar në kategorinë paga dhe mëditje, ishte në shumën prej 57,191,921.00 euro, kurse buxhet i shpenzuar në shumë prej 76,250,921.00 euro, kurse diferenca është në shumë prej -19,059,000.00 euro.

Sa i përket vitit 2021, buxheti fillestar në kategorinë paga dhe mëditje, ishte në shumën prej 56,076,877.00 euro, kurse buxhet i shpenzuar në shumë prej 73,825,422.00 euro, kurse diferenca është në shumë prej -17,748,544.00 euro.

Po ashtu sa i përket vitit 2022, buxheti fillestar në kategorinë paga dhe mëditje, ishte në shumën prej 62,757,261.00 euro, kurse buxhet i shpenzuar në shumë prej 70,231,105.00 euro, kurse diferenca është në shumë prej -7,473,844.00 euro.

Këtij njoftimi, gjykata i ka falë besimin në tërësi, sepse i njëjti është i lëshuar nga një organ zyrtar shtetëror e me të cilin u vërtetua fakti vendimtar dhe përcaktues. Ku sipas nenit 329.1 parashihet se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*. Arsye tjetër se pse gjykata i ka falur besimin në tërësi këtij njoftimi, është nga shkakut se të dhënat financiare, përkatësisht kategoria për paga dhe mëditje e përcaktuar për vitin 2022, gjen mbështetje në Ligji Nr. 08/L-066 Mbi Ndarjet Buxhetore Për Buxhetin E Republikës së Kosovës për Vitin 2022, ku në tabelën 3.1 – Buxheti i Nivelit Qendror (në euro) kodit 220 – Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar, për paga dhe mëditje kishte shumën prej 62.757,261.00 euro. Sipas nenit 12 të këtij Ligji, par. 6 përcaktohet ndër të tjera se *shpenzimi i parave publike nga kategoria e për mallra dhe shërbime,*

nuk është i lejuar për pagesën e punëtorëve, qoftë në formën e shtesave.... Përmes kësaj kuptojmë, se edhe sikur e paditura të kishte pas suficit buxhetor në këtë linjë tjetër buxhetore, e ka të ndaluar që të bëjë kompensimin për kategorinë e kërkuar nga pala paditëse. Sipas nenit 2 të po të njëjtit ligj, *këto dispozita ligjore janë të detyrueshme për të gjitha institucionet dhe njësitë përkatëse të tyre që bien në fushëveprimin e buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2022.*

Një gjendje e njëjtë, paraqitet edhe për vitin 2021, gjen mbështetje në Ligji Nr. 07/L-041 Mbi Ndarjet Buxhetore Për Buxhetin E Republikës së Kosovës për Vitin 2021, ku në tabelën 3.1 – Buxheti i Nivelit Qendror (në euro) kodi 2020 – Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar, për paga dhe mëditje kishte shumën prej 56,076,877.00 euro. Sipas nenit 13 të këtij Ligji, par. 6 përcaktohet ndër të tjera se *shpenzimi i parave publike nga kategoria e për mallra dhe shërbime, nuk është i lejuar për pagesën e punëtorëve, qoftë në formën e shtesave....* Përmes kësaj kuptojmë, se edhe sikur e paditura të kishte pas suficit buxhetor në këtë linjë tjetër buxhetore, e ka të ndaluar që të bëjë kompensimin për kategorinë e kërkuar nga pala paditëse. Sipas nenit 2 të po të njëjtit ligj, *këto dispozita ligjore janë të detyrueshme për të gjitha institucionet dhe njësitë përkatëse të tyre që bien në fushëveprimin e buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2021.* Për më tepër, edhe me Ligji nr. 08/l-016 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 07/l-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, në shtojcën 1 të këtij ligji, Kufijë e Buxhetit për vitin 2021, ishte bërë rritja e të hyrave në kategorinë për paga dhe mëditje në shumë prej 61,800,180 euro, mirëpo edhe kjo nuk kishte mjaftuar, dhe shpenzimet kanë qenë edhe më të mëdha e në shumë prej 73,825,422.00 euro.

Një gjendje e njëjtë, paraqitet edhe në vitin 2020 dhe ky njoftim gjen mbështetje edhe në Ligji Nr. 07/L-001 Mbi Ndarjet Buxhetore Për Buxhetin e Republikës së Kosovës Për Vitin 2020, konkretisht në tabelën nr. 3.1 Buxheti i Nivelit Qendror, ku për kategorinë për paga dhe mëditje ishin paraparë në shumën prej 57,190,922 euro. Edhe në këtë ligj, me nenin 13 parashihej situata e njëjtë si më lartë, e ndalesës së pagesës së punonjësve nga kategoria për mallra dhe shërbime. Më pas, Ligji Nr. 07/L-014 Për Ndryshimin Dhe Plotësimin E Ligjit Me Nr.07/L-001 Mbi Ndarjet Buxhetore Për Buxhetin e Republikës së Kosovës Për Vitin 2020, ishte bërë rritja e të hyrave në këtë kategori në 61,101,647 euro, por që edhe kjo ishte tejkaluar deri në shumën prej 76,250,921.00 euro.

Po ashtu, edhe në vitin 2019, me Ligji Nr. 06/L -133 Mbi Ndarjet Buxhetore Për Buxhetin E Republikës së Kosovës Për Vitin 2019 - Tabelat E Buxhetit Për Vitin 2019, të hyrat për paga dhe

mëditje për SHSKUK ishin paraparë në shumën prej 57,945,237.00 euro, e që kanë përputhje me njoftimin e dorëzuar si provë nga e paditura.

Edhe sa i përket viti 2018, nuk kishim ndonjë ndryshim dhe po me Ligji Nr. 06/L-020 Për Buxhetin e Republikës së Kosovës Për Vitin 2018 - Tabelat E Buxhetit Për Vitin 2018, ishin paraparë të hyrat për të paditurën për kategorinë për paga dhe mëditje në shumën prej 58,242,229.27 euro, e që të njëjtat janë tejkualuar.

Edhe në këto dy ligje materiale që kanë qenë në fuqi secili në kohën kur paditësit kanë kërkuar kompensimin e pagave të 13-ta, kompensimet nga kategoritë apo linjat e tjera buxhetore si mallra dhe shërbime, kanë qenë të ndaluara.

Në këtë kuptim, pala e paditur përmes njoftimit e datës. 21.12.2023 me numër protokollit 3823, i ka provuar pretendimet e veta, se në fakt në periudhat në të cilat paditësit kanë kërkuar kompensimin e pagës së 13-të, nuk kanë pasur mundësi buxhetore. Në bazë të vështimit të kësaj prove materiale, gjykata gjeti se nga e paditura është vënë në pah fakti se ajo si organizatë buxhetore e pavarur, është ballafaquar me vështirësi buxhetore e të cilat i janë mbuluar nga Ministria e Financave, e që do të thotë se ka arritur të provojë faktin se nuk gëzon mundësi të mjaftueshme buxhetore në raport me përmbushjen e obligimit për kompensimin e pagës së 13-të për vitet, 2020, 2021 dhe 2022.

-Lidhur me prapësimin e të paditurës për parashkrimin e kërkesës:

Gjykata pas vlerësimit të prapësimit material të paditurës lidhur me parashkrimin e kërkesës, ka konstatuar se kërkesa e paditësve është e përfshirë edhe në parashkrim për vitet 2018 dhe 2019, duke u bazuar në nenin 87 të Ligjit Nr.03/L212 të Punës, i cili ka përcaktuar që “*Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës*”, e po ashtu pati parasysh edhe nenin 342 par.1 të LMD-së, sipas të cilit “*Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër*”. Paditësi, padinë e kanë paraqitur me datë 14.11.2023, e në qoftë se kërkesa për kompensimin e pagës së 13-të, do të kishte themelësi atëherë e njëjta do të kompensohej në fund të vitit 2018, e që nga fundi i vitit 2018 e deri me paraqitjen e padisë kanë kaluar më shumë se 4 vite e gjysmë, ndërsa në llogaritje për kërkesën e pagës së 13-të, të vitit 2019, e njëjta do të

kompensohej në fund të vitit 2019, pra pasi që padia është paraqitur me datë 14.11.2023, konstatohet se kanë kaluar më shumë se 3 vite e gjysmë, e një gjë e tillë vlen edhe sa i përket pagës jubilarë..

Gjykata në bazë të provave të cila gjenden në shkresat e lëndës ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit në emër të kompensimit të pagës jubilarë si në pikën I të dispozitivit të këtij Aktgjykimi, e cila ka mbështetje në dispozitat e nenit 17 paragraf 3.1 dhe 4 të Kontratës Kolektive Sektoriale e lidhur në mes të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, ku përcaktohet se 3.1 *“punëtori ka të drejtë në shpërblimin jubilar për 10 vjet të përvojës në punë në institucione shëndetësore, në vlerë të një page mujore të tij; 4. Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë. Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf”*, Po ashtu kusht ligjor për njohjen e shpërblimit jubilar është që paditësi vitin jubilar të përvojës së tij të punës, tek e paditura të këtë arritur brenda vlefshmërisë së Kontratës Kolektive Sektoriale, pra Kontrata Kolektive Sektoriale e lidhur në mes të Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës dhe Ministrisë së Shëndetësisë, ka qene në fuqi në periudhën kohore tri (3) vjeçare e cila kontrate është shkëputur me datë 21.11.2022 nga Ministria e Shëndetësisë, andaj kërkesëpadia e paditësit nuk është paraqitur brenda afatit si dhe paditësi kontratën e parë të lidhur me institucionet e shëndetësisë e ka lidhur me dt. 01.02.2013, e deri tek paraqitja e padisë dt. 14.11.2023, janë arritur 10 vite përvojë të punës në institucionet shëndetësore, por kontrata Kontrate Kolektive Sektoriale është shkëputur me dt. 21.11.2022, andaj kërkesa për këtë të drejtë është paraqitur pasi ka kaluar afatit kohor me të cilën ka vepruar Kontrate Kolektive Sektoriale, e që në rastin konkret rezulton paditësit nuk i takon kjo e drejtë në emër të shpërblimit jubilar.

Gjykata ka vlerësuar dhe pretendimet e tjera të palës paditëse e po ashtu edhe asaj të paditur, por të njëjtat nuk kishin ndonjë rëndësi për vendosje ndryshe nga ana e gjykatës, sepse padisë i ka munguar baza juridike.

Lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore, gjykata ka vendosur bazuar në nenin 450 *“Secila palë paraprakisht vetë i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta”*, e lidhur me nenin 463.1 *“Për pagimin e shpenzimeve procedurale gjykata vendosë vetëm me kërkesën e specifikuar të palës, pa bërë asnjë shqyrtim verbalisht lidhur me kërkesën”*-të LPK-së.

Nga sa u tha më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e bazuar në nenin 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2023:246090, C.nr/3562/23, 07.03.2025

Gj y q t a r i:
Vegim Maloku

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 dite, nga dita e pranimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes të kësaj gjykate.